



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.1, 1.6, 1.9, 1.12, 1.17 dhe 1.24 të Ligjit Nr. 06/L055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 13 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 18 dhe nenit 24 paragrafi 1, pika 1.3, nenit 32, të Ligjit Nr. 06/L- 054 për Gjykatat, nenit 6 të Rregullores Nr. 03/2019 për Organizimin dhe Funkcionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, dhe Vendimit KGJK. Nr. 239/2029 datë: 12 qershor 2023, shpall:

**KONKURS TË BRENDSHËM PËR GJYQTARË**  
*të cilët do ta ushtrojnë funksionin e tyre në kuadër të*  
*Departamentit Special në Gjykatën Themelore Prishtinë*

**I. Gjykata Themelore Prishtinë ..... 3 (tri) pozita**

**KRITERET**

1. Për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të Apelit, kandidati duhet t'i plotësoj kushtet që kërkohen për emërimin e gjyqtarit në baza të nenit 30 Ligjit Nr. 06/L- 054 për Gjykatat, kushtet e veçanta për gjyqtare të parapara me nenin 32 paragrafi 1, pika 1.1 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 06/L- 054 për Gjykatat, si dhe kriteret plotësuese sipas nenit 5 paragrafi 1, 2 dhe 3 Rregullores Nr. 03/2019 për Organizimin dhe Funkcionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit.

## **TE DREJTE APLIKIMI**

Në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë kanë të drejtë aplikimi të gjithë gjyqtarët që plotësojnë kushtet e veçanta për gjyqtar konform nenit 32 paragrafi 1 pika 1.1, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 06/L- 054 për Gjykatat dhe sipas nenit 5 paragrafi 1, 2 dhe 3 Rregullores Nr. 03/2019 për Organizimin dhe Funkcionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

KGJK inkurajon pjesëtarët e komunitetit joshumicë dhe gjinisë femrore që të konkurojnë.

## **FORMULARI I APLIKIMIT**

- formularin mund ta shkarkojnë në Ueb faqen e KGJK-së. ([www.gjyqesori-rks.org](http://www.gjyqesori-rks.org))

[Shkarko Aplikacionin](#)

## **MËNYRA E APLIKIMIT**

- Në mënyrë fizike: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Rruga: ‘‘Luan Haradinaj’’ nr. 133, Zyrja nr. 009, Prishtinë

- Aplikacioni i dorëzuar në mënyrë fizike duhet të jetë i mbyllur në zarfë.

## **AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE**

- **Data e fillimit e aplikimi: 16 Qershor 2023**
- **Data e fundit e aplikimit: 30 Qershor 2023**

## **RREGULLAT DHE PROCEDURAT**

Kandidatëve që aplikojnë për pozitat përkatëse do t`ju kërkohen dokumente të ndryshme për të mbështetur aplikacionin e tyre. Lidhur me këtë çështje, secili kandidat do të kontaktohet individualisht dhe përmes e -mail adresave për t`ju dërguar formularët dhe detajet për procedurat e mëtutjeshme.